

UDHEZIM

Nr.15, date 16.7.2003

"PER PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SE SALLAVE TE LOJERAVE ARITMETIKE, ELEKTRONIKE DHE PIKAVE TE LOJERAVE TE FATIT SPORTIVE"

Ne mbështetje te nenit 102/4 te Kushtetutës se Republikës te Shqipërisë, ligjit nr.8701, date 1.12.2000 "Për lojërat e Fatit, Kazinotë dhe Hipodromet" dhe ne zbatim te nenit 1 pika 2 te vendimit te Këshillit te Ministrave nr.238, date 13.4.2001 "Për kriteret e dhënies se lejes për lojërat e fatit kazinotë dhe hipodromet" Ministri i Financave

U D H E Z O N:

1. Shoqëritë e lojërave te fatit për hapjen e sallave te reja te lojërave aritmetike dhe elektronike duhet te paraqesin ne Drejtorinë e Lojërave te Fatit, kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë se Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkese për hapjen e sallës dhe adresën e sakte te saj.

b) Te dhënat e mëposhtme për personelin e sallës:

1. Certificate personale te personelit

2. Vërtetim te gjendjes gjyqësore te personelit

3. Dëshmi kualifikimi te personelit

4. Kontrate pune te personelit.

c) Certificate nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit e teknologjisë përkatëse.

d) Garancinë për fituesin e lojës për automate ose salle bingo.

e) Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për sallën e re.

f) Vërtetim pronësie, deklarate zhdoganimi dhe certificate origjine për pajisjet.

g) Rregulloret përkatëse për lojërat qe do te zhvillohen ne këto salla.

h) Standardin e biletës për salla te bingos.

2. Shoqëritë e lojërave te fatit, për hapjen e pikave te lojërave te fatit sportive duhet te paraqesin ne Drejtorinë e Lojërave te Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë se Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkese për hapjen e pikave dhe adresën e sakte te saj.

b) Akte blerjeje, fatura te tjera për teknologjinë përkatëse.

c) Vërtetim te gjendjes gjyqësore për personelin e pikës se lojërave te fatit sportive.

d) Kontrate pune te personelit te pikave te lojërave te fatit sportive.

e) Dëshmi kualifikimi për personelin e pikës se lojërave te fatit sportive.

f) Vërtetimin e pronësisë se pikave te lojërave te fatit sportive ose kontratën e qirasë.

3. Shoqëritë e lojërave te fatit për mbylljen e sallave te lojërave aritmetike, elektronike dhe te pikave te lojërave te fatit sportive duhet te paraqesin ne Drejtorinë e Lojërave te Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë se Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkese për mbylljen e sallës.

b) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore për sallat e lojërave aritmetike, elektronike. c) Zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira.

4. Brenda 3 mujorit të parë të vitit shoqëritë e lojërave të fatit duhet të paraqesin në Drejtorinë e Lojërave të Fatit listën e personave që do të trajnohen për marrjen e dëshmive të kualifikimit në fushën e lojërave të fatit.

5. Shoqëritë e lojërave të fatit, për transferimin e automateve të miratuara nga sallat ekzistuese në salla të tjera duhet të paraqesin në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkese për transferimin e automateve.

b) Arsyet e transferimit të automateve.

6. Mbyllja e sallave të lojërave aritmetike, elektronike dhe pikave të lojërave të fatit sportive nuk mund të bëhet pa kaluar 1 (një) vit nga dita e miratimit të tyre nga Ministria e Financave. Kjo mbyllje mund të bëhet përpara këtij afati vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme.

7. Transferimi i automateve nuk mund të bëhet pa kaluar 6 (gjashtë) muaj nga data e miratimit të tyre nga Ministria e Financave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Kastriot Islami